



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2020:158394

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05563326

**E.nr.816/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit F.A. nga Shtimja, të cilin e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Qendra për Integrim dhe Rehabilitim e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime, për pagesën e shpërblimit jubilar, dhe shpenzimet të procedurës, më datë 11.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.816/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës e kreditorit.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.816/23, të datës 05.05.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Qendra për Integrim dhe Rehabilitim e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime, kompensim i pagës jubilarë dhe për pagesën e shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.1790/20, të datës 30.06.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 06.10.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,020.40 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.816/23, më datë 11.04.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**